

KËRKESË
Nr. 68/9, datë 25.7.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Rikonstruksion dhe ndërtim i rrugëve ‘Ksanthipi Zyko’ dhe ‘Abdyl Ypi’, Bashkia Durrës”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 9,241,113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzetë e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Durrës.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall” bazuar në VKM- në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

- Për pasuritë e llojit “ndërtesë” është bërë bazuar në VKM nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, referuar çmimit mesatar të shitblerjeve për banesat, të konfirmuar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Durrës me shkresën nr. 3721/1 prot., datë 13.6.2023.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Durrës, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 9,241,113.3 (nëntë milionë e dyqind e dyzetë e një mijë e njëqind e trembëdhjetë pikë tre) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “RIKONSTRUKSION DHE NDËRTIM I RRUGËVE ‘KSANTHIPI ZYKO’ DHE ‘ABDYL YPI’, BASHKIA DURRËS”

N. r.	PRONARI			Të dhëna hipotekore							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						Vlera totale/lekë	Shënime (kufizime hipotekore, barre mbi pasurinë etj.)
	Emër	Atësia	Mbie mër	Fshati/q yteti	Z.Kadas trale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.total e/m ²	Truall /m ²	Ndërtesë/ m ²	TRUALL			NDËRTESE				
											Sipërfaqj a/m ²	Çmim i (lekë/ m ²)	Vlera/lekë	Sipërfaqja /m ²	Çmimi (lekë/ m ²)	Vlera/lekë		
1	Albert	Hasan	Abazaj	Durrës	8513	2/927	truall	509	509	260	220	12,945	2,847,900	0	0	0	2,847,900	
2	Hasan		Abazi	Durrës	8513	2/929/ND	ndërtesë	20	0	20	0	0	0	20.00	67,500	1,350,000	1,350,000	E- Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 2/645 vol. 38, f. 245. D- e vlefshme vetëm për të mundësuar blerjen e truallit.
3	Nurije		Falli	Durrës	8513	2/643	truall	134,94	134,94	59	76	12,945	983,043.3	59	67,500	3,982,500	4,965,543.3	Vihet në H/L në favor të fondit Besa me Khip nr. 1778/486/4 datë 26.6.2018
4	Lavdri m		Balla	Durrës	8513	2/997	truall	103	103	52	6	12,945	77,670	0	0	0	77,670	
	Drita	Musa	Balla															
	SHUMA												3.908.613.3			5.332.500	9.241.113.3	